



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KURBIN

Nr. 5347/2 Prot

Laç më 01/12/2023

V E N D I M

Nr 27 Datë 23/11/2023

**PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE SI DHE VENDOSJES SË PENALITETEVE
NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Mbështetur në:

Ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 9, pika1/1.3, gërma ”b”, neni 35, pika 4, neni 54, gërma ”f”; Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, neni 5, gërma ”b”, ”c” dhe ”ç”, neni 7, neni 9 etj.; Ligjin nr.106/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr.9632/2006”; Ligji nr.106/2017 “Për disa shtesa në ligjin nr.9632/2006”; Ligji nr.67 datë 21.07.2023 “Për një ndryshim dhe disa shtesa në Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”; Ligjin nr.9920/2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 ”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr.115/2014 ” Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.9975 ” Për Taksat Kombëtare ”, i ndryshuar; Ligjin nr.9723/2007 ”Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar; Ligjin nr.10465 datë 29.09.2011 ” Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 ” Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 ”Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr.10304 datë 15.07.2010 ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr.8450 date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar me V.K.M nr.970 date 02.12.2015; Ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” neni 12; Ligjin nr.10279 date 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”; Ligjin nr.152/2015 datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”; Ligjin 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është:
Njësia Administrative ose Agjenti Tatimor, sipas rastit.

Shënim: Për të gjithë subjektet private, Fizike/Juridike të Bashkisë Kurbin, të cilët nuk shlyejnë detyrimin tatimor brenda afateve të përcaktuara sa më lart marrin gjobë në masën 0.06% të detyrimit fiskal për çdo ditë vonesë.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e gjobës;
Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore.

Rakordimi dhe shkëmbimi i informacionit

Çdo drejtues drejtorie, përgjegjës, që është i ngarkuar si strukturë përgjegjëse për dërgimin e të dhënave zyrtare tek Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të dhëna të cilat i shërbejnë asaj drejtorie për të përlogaritur masën e detyrimeve për taksapaguesit, nbi të cilin do të bëhet lëshimin e faturës për arkëtim të zërit të taksës apo tarifës përkatëse dhe njëkohesisht ndjekjen e vjeljes së saj, ka detyrim të mbajë një regjistër (database të veçantë) për çdo zë të taksave dhe tarifave sipas të dhënave të dërguara, si dhe të rakordoje veprimet e kryera çdo fundmuaji me Drejtorinë e Planifikimit të Ardhurave Vendore e cila më pas kryen rakordimin mujor të realizimit të planit të të ardhurave sipas zërave të planifikuar.

Për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit ngarkohen, Njësitë Administrative Kurbin, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashki, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Mjedisit, Policia Bashkiake, Agjensitë në varësi dhe Agjentët Tatimorë në realizim të objektivit që synon Bashkia Kurbin.

> Prefektit të Qarkut Lezhë

> Arkivit

“Vendimi i Këshillit të Bashkisë Kurbin Nr. 91 datë 18/11/2022” shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit
Arbër Leka



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira LLESHI

Edlira LLESHI

